

## **Kushtet e Përgjithshme të sigurimit të mallrave në transport.**

### **Neni 1. Përcaktime të përgjithshme**

**1.1.** Kushtet e përgjithshme të kontratës për sigurimin e Mallrave në transport, këtu e në vazhdim do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit".

**1.2.** ALBSIG SHA, këtu e në vazhdim do të quhet shkurtimisht "Siguruesi".

**1.3.** Personi fizik ose juridik, interesi pasuror ose i sigurueshëm, i të cilit do të mbulohet sipas këtyre Kushteve të Përgjithshme, këtu e në vazhdim do të quhet shkurtimisht "i Siguruari".

**1.4.** Me objekt të sigurimit do të kuptojmë mallrat që mbartin cilesinë "të tregtueshëm" (të transferueshëm), përveç sendeve vetjake dhe furnizimeve (mallrave si karburante, ushqime etj.) të destinuar për nevoja të realizimit të transportimit të ngarkesave të siguruara.

Me qëllim të përfitimit të dëmshpërblimit i Siguruari duhet të ketë interes të sigurueshëm në objektin e siguruar, në momentin e ndodhjes së dëmit.

Në funksion të pohimit të mësipërm i Siguruari do të ketë të drejten e dëmshpërblimit për ngjarje sigurimi të ndodhura në periudhën e mbuluar prej këtij sigurimi, pavarësisht se humbja ka ndodhur përpara kohës në të cilën është lidhur kontrata e sigurimit, me kusht që si i Siguruari ashtu edhe Siguruesi, nuk kishin dijeni, për humbjen e ndodhur.

### **Neni 2. Përcaktime të veçanta**

#### **2.1. Avaria e Përgjithshme.**

Kemi Avari të Përgjithshme, kur një sakrifice ose shpenzim i jashtëzakonshëm i urdhëruar nga kapiteni i anijes, me qëllim shpëtimin e pasurive (të gjithë vlerave të përfshira në një lundrim, të anijes, mallit dhe navllos), kryhet në mënyrë të vullnetshme dhe të arsyeshme, në kohën kur një rrezik i përbashkët kërcënon këto pasuri.

Kur ka humbje nga Avaria e Përgjithshme, pala mbi të cilën kjo humbje bie, fiton të drejten sipas parashikimeve të përcaktuara nga Drejta Ndërkombëtare Detare, për një kontribut të përpjeshtëm nga subjektet e tjera të interesuara dhe të përfshirë nga ngjarja kërcënuese (por që nuk kanë pësuar humbje, ose ato janë më të vogla proporcionalisht), dhe i tillë kontribut quhet kontributi i Avarisë së Përgjithshme.

#### **2.2. Shpenzimet e Shpëtimit.**

Me Shpenzime Shpëtimit kuptojmë shpenzimet e rikthyeshme të bëra nga një Shpëtues, sipas të Drejtës Ndërkombëtare Detare dhe Kodit Detar të R.SH, pavarësisht marrëdhënieve kontraktore me përfituesin e këtyre shpenzimeve.

Ato nuk përfshijnë shpenzimet e sherbimeve të natyrës së Shpëtimit dhënë nga i Siguruari ose agjentët e tij, ose çdo person i punësuar me pagese prej tyre, me qëllim shmangjen përkundrejt një rreziku të siguruar. Këto shpenzime (sherbimi), kur kryhen në mënyrë të përshtatshme mund të mbulojnë si shpenzime të veçanta ose si humbje nga Avaria e Përgjithshme, në përputhje me rrethanat në të cilat ato janë kryer.

**2.3.** Transporti do të quhet i brendshëm, kur vendi i nisjes dhe destinacionit (magazina përfundimtare) gjenden në territorin e R.SH. Me transport të jashtëm (import/eksport) do të kuptojmë lëvizjen e mallrave, ku njëra nga pikat ajo e nisjes së mallrave ose e destinacionit gjendet në territorin e R.SH.

Me transport tranzit do të kuptojmë lëvizjen e mallrave nëpër territorin e R.SH, por kur asnjëra nga pikat ajo e nisjes ose e destinacionit nuk gjenden në territorin e R.SH.

### **Neni 3. Shtrirja e mbulimit me sigurim të mallrave në tranzit**

#### **3.1. Niveli A.** Nga të gjitha rreziqet (All Risks).

Sigurimi sipas nivelit A, mbulon të gjitha rreziqet e humbjeve dhe ose dëmeve të pësuar në objektin e siguruar, përveç atyre të përjashtuara shprehimisht, sipas parashikimeve të neneve 4, 5, 6 dhe 7 më poshtë.

#### **3.2. Niveli B.**

Sigurimi sipas nivelit B, përfshin të gjitha dëmet e objektit të siguruar, të pësuar nga rreziqet e emërtuar më poshtë, gjithnjë në funksion të përjashtimeve të neneve 4, 5, 6 dhe 7.

**3.2.1.** zjarr, eksplozion,

**3.2.2.** aksidentit të mjetit të transportit, anijes, mjetit të transportit tokësor, hekurudhor, ajror.

#### **për anijen.**

- nxjerrje në breg, ngecje në rërë, cekëtitrë, fundosje, anim,

- përplasje me çdo objekt të jashtëm përveç ujit,

- shkarkimit të ngarkesës në portin e fatkeqsisë,

- tërmet, shpërthim vullkanik, rufe,

- sakrifica e avarisë së përgjithshme,

- humbja e mallrave për efekt të hedhjes së ngarkesës për lehtësimin e anijes, dhe rënia e ujrave (të detit, liqenit, lumit), mbi bordin e anijes,

- hyrja e ujrave (të detit, liqenit, lumit), në anije, hambar, konteiner ose vendin e ruajtjes së objektit të siguruar,

**për mjetin tokësor dhe hekurudhor,** përplasje, dalje nga rruga dhe/ose përmbysje, dalje nga shinat.

- humbja totale dhe/ose dëmtimi i çdo pakoje të ambalazhuar me mall, përgjatë ngarkim shkarkimit për në ose nga anija, ose mjeti tjetër ujor dhe/ose tokësor.

**për mjetin ajror,** pësimi i çdo ngjarje të jashtëzakonshme.

#### **3.3. Niveli C.**

Sigurimi sipas nivelit C, përfshin të gjitha dëmet e objektit të siguruar, të pësuar nga rreziqet e emërtuar më poshtë, gjithnjë në funksion të përjashtimeve të neneve 4, 5, 6 dhe 7.

**3.3.1.** zjarr, eksplozion,

**3.3.2.** aksidentit të mjetit të transportit, anijes, mjetit të transportit tokësor dhe hekurudhor,

#### **për anijen.**

- nxjerrje në breg, ngecje në rërë, cekëtitrë, fundosje, anim,

- përplasje me çdo objekt të jashtëm përveç ujit,

- shkarkimit të ngarkesës së siguruar në portin e fatkeqsisë,

- sakrifica e avarisë së përgjithshme,

- humbja e mallrave për efekt të hudhjes së ngarkesës për lehtësimin e anijes,

**për mjetin tokësor dhe hekurudhor,** përplasje, dalje nga rruga dhe/ose përmbysje, dalje nga shinat.

**për mjetin ajror,** pësimi i çdo ngjarje të jashtëzakonshme.

### **Neni 4. Përjashtime të Përgjithshme**

Në asnjë rast ky sigurim nuk do të mbulojë:

**4.1.** humbje dëme ose shpenzime që janë pjesë e shpërdorimeve të qëllimshme të Siguararit,

**4.2.** rrjedhje të zakonshme, humbje të zakonshme në peshë dhe volum, amortizimit të zakonshëm të objektit të siguruar (mallrave),

**4.3.** humbje dëme ose shpenzime shkaktuar prej pamjaftueshmërisë ose papërshtatmërisë së paketimit ose përgatitjes së objektit të siguruar (për qëllim të këtij kushti 4.3 "të paketuarit" do të gjykohej të përfshije edhe stivimin në konteiner ose në vagonin vetëshkarkues, por vetëm kur ky stivim është kryer para fillimit të këtij sigurimi, ose është kryer prej të Siguararit ose punonjësve të tij,

**4.4.** humbje, dëme ose shpenzime shkaktuar prej veseve të brendshme ose të natyrës së objektit të siguruar,

**4.5.** humbje dëme ose shpenzime të shkaktuara direkt prej vonesës bile edhe në se vonesa shkaktohet prej një rreziku të siguruar (përveç shpenzimeve të pagueshme sipas nenit 2.1. më sipër, Avaria e Përgjithshme),

**4.6.** humbje dëme ose shpenzime të pësuar prej falimentimit ose pamundësisë financiare për të paguar të pronarëve, menaxherëve, qeramarrësve ose operatorëve të anijes,

**4.7.** humbje dëme ose shpenzime të pësuar prej përdorimit të çdo arme lufte, që përfshin zbrëthim dhe/ose bashkim atomik ose bërthamor ose të tjera reaksione të ngjashme ose fuqi ose lëndë radioaktive.

### **Neni 5. Përjashtime për Pavlefshmërinë dhe Papërshtatshmërinë e mjeteve të transportit**

Në asnjë rast ky sigurim nuk do të mbulojë humbje, dëme ose shpenzime shkaktuar prej:

**5.1.** pavlefshmërisë për të lundruar dhe/ose transportuar të anijes dhe/ose mjetit tjetër tokësor,

papërshtatmërisë së anijes dhe/ose mjetit tjetër të transportit tokësor, konteinerit ose vagonit vetëshkarkues, për transportimin e sigurve të objektit të siguruar,

kur i Siguruari ose punonjësit e tij janë në dijeni (ose kanë dyshime), për të tillë pavlefshmëri ose papërshtatshmëri, në kohën kur objekti i siguruar ngarkohet në të,

**5.2.** Siguruesit heqin dore prej çdo shkelje të garancive të nënkuptuara të vlefshmërisë dhe përshtatshmërisë së anijes dhe mjetit tjetër tokësor, për të dërguar objektin e siguruar në destinacion, po të mos kenë i Siguruari ose punonjësit e tij dijeni ose dyshime, për të tillë pavlefshmëri ose papërshtatshmëri.

#### **Neni 6. Përfundimet e Luftës**

Në asnjë rast ky sigurim nuk do të mbulojë humbje të mëdha përgjegjësi ose shpenzime shkaktuar prej:

**6.1.** luftës, luftës civile, rebelimit, kryengritjes ose mosmarrëveshjeve civile ardhur prej tyre, ose çdo akti armiqësor kryer prej ose kundër një fuqie ndërluftuese,

**6.2.** zënien rob, sekuestrimin, arrestimin, pengimin (përfshirë piraterinë, vetëm për të Siguarit, sipas nivelit A), pasojave të shkaktuara prej tyre dhe çdo tentative për t'i kryer ato,

**6.3.** minave të braktisura, silurave ose të tjera mjete lufte të braktisura.

#### **Neni 7. Përfundimi i Grevave**

Në asnjë rast ky sigurim nuk do të mbulojë humbje, dëme, përgjegjësi ose shpenzime:

**7.1.** shkaktuar prej grevisteve, atyre që realizojnë lock out-e, ose personave që marrin pjesë në turbullira lidhur me punën, trazira ose rebelime civile,

**7.2.** që rezultojnë nga grevat, lock out-tet, turbullirat e punës, trazirat ose rebelimet civile,

**7.3.** shkaktuar prej çdo terroristi ose çdo personi që vepron nga një motiv politik.

#### **Neni 8. Kohëzgjatja e Kontratës (periudha e mbulimit)**

**8.1** Ky sigurim fillon që nga koha që mallrat lëvizin (në mjetin e ngarkuar), nga magazina ose vendi magazinimit, në vendin e përcaktuar në kontratë për fillimin e tranzitimit, vazhdon përgjate kursit të zakonshëm të tranzitit dhe përfundon në kohën e çfaqjes më të parë të sejcilit prej rasteve të mëposhtme:

8.1.1. me dorëzimin të pritësit ose magazinën përfundimtare ose vendin e magazinimit në destinacionin e përcaktuar në kontratë,

8.1.2. me dorëzimin në çdo tjetër magazinë ose vend magazinimi, më përpara ose në destinacionin e përcaktuar në kontratë, të cilin i Siguruari zgjedh të përdorë (por gjithmonë përgjate kursit të zakonshëm të tranzitit).

8.1.2.1. për magazinim (nxitur nga nevoja të ndryshme p.sh. magazine doganore etj, të kësaj natyre), në kursin e zakonshëm të tranzitit,

8.1.2.2. për ndarje ose shpërndarje (në parti të mallit), ose

8.1.3. me mbarimin e 14 ditëve, mbas përfundimit të shkarkimit të mallrave të siguruar nga anija, në portin përfundimtar të shkarkimit.

**8.2.** Nëse mbas shkarkimit nga anija në portin final të shkarkimit, por para përfundimit të këtij sigurimi (afati 14 ditor), mallrat dërgohen në një destinacion tjetër (malli rishitet tek një klient i të Siguruarit), ndryshe prej atij ku ato janë siguruar fillimisht në këtë kontratë, ky sigurim, ndërsa mbetet në varesi të përfundimit sipas parashikimit më sipër (8.1.3.), nuk do të shtyhet në afat më tej, se fillimi i tranzitit për tek destinacioni tjetër.

**8.3** Ky sigurim do të mbetet në fuqi (në varësi të përfundimit si parashikuar më sipër dhe parashikimeve të kushtit Nr.9 më poshtë), përgjate vonesave përtej kontrollit të Siguarit, çdo devijimi, shkarkimi të detyruar, ringarkimi ose transbordimi dhe çdo variacioni të kësaj ndërmarrje, shkaktuar prej ushtrimit të drejtave që pronarët e anijeve ose qeramarrësit gëzojnë, sipas kontratës së transportit.

#### **Neni 9. Përfundimi i kontratës së transportit**

**9.1** Nëse për shkak të rrethanave përtej kontrollit të Siguarit, kontrata e transportit përfundon në një port ose vend tjetër, ndryshe prej destinacionit të përcaktuar në këtë kontratë, ose ndryshe transporti përfundon para dorëzimit të mallrave sikurse parashikohet prej kushtit 8 më sipër, atëherë ky sigurim gjithashtu do të përfundojë, *po të mos i jepet Siguruesve një njoftim i menjëhershëm dhe vazhdimi i mbulimit të kërkuar të këtij sigurim është në varësi të pranimit dhe të një prirje shtesë, nëse kërkohet prej Siguruesve, dhe momenti i përfundimit do të shtyhet,*

9.1.1 deri kur mallrat të shiten ose dorëzohen në të tillë port ose vend, ose në se nuk është rënë dakort veçanërisht, deri në mbarimin e 14 ditëve mbas mbërritjes së mallrave në këtë port ose vend, cilado të ndodhë e para, ose

9.1.2 në se mallrat dërgohen brenda periudhës së përmendur prej 14 ditëve (ose çdo shtese në kohë të rënë dakort), në destinacionin e përcaktuar në kontratë, ose në çdo tjetër destinacion, deri në përfundimin në përputhje me parashikimet e kushtit 8-të më sipër.

**9.2** Nëse kontrata e sigurimit është lidhur me afat kohor dhe jo për një udhëtim të përcaktuar, palët mund ta ndërpresin kontratën në çdo kohë, por jo më parë se 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit të ndërprerjes së saj nga pala tjetër.

#### **Neni 10. Ndryshimi i lundrimit, nga linja e zakonshme e tij**

Kur mbas fillimit të këtij sigurimi destinacioni i mjetit të transportit (pra edhe i mallrave të siguruar, të ngarkuar në këto mjete), ndryshohet prej të Siguarit, *ky sigurim do të jetë i vlefshëm vetëm nëse palët bien dakort për një prim dhe kushte të tjera, gjithnjë në varësi të njoftimit të menjëhershëm dhënë Siguruesve, për ndryshimin e destinacionit.*

#### **Neni 11. Kushti i Spedicionit (dërgimit)**

Kur si rezultat i veprimit të një rreziku të mbuluar sipas këtij sigurimi, tranziti i siguruar përfundon në një port ose vend tjetër, ndryshe nga ai port ose vend, në të cilin objekti i siguruar ishte i mbuluar prej këtij sigurimi, Siguruesit do të rimburojnë të Siguarin për çdo shpenzim suplementar, të kryer në mënyrë të arsyeshme dhe të përshtatshme, për shkarkimin, magazinimin dhe dërgimin e objektit të siguruar (mallit), në destinacionin në të cilin ishte siguruar sipas kësaj kontrate.

Parashikimet e këtij neni (11), i cili nuk aplikohet në Avarinë e Përgjithshme ose Shpenzimet e Shpëtimit do të jetë në varësi të përjashtimeve që përmbahen në nenet 4, 5, 6 dhe 7 më sipër, dhe nuk do të përfshijë shpenzimet e pësuar nga të metat, pakujdesia, falimenti ose pamundësia financiare e të Siguarit ose nëpunësve të tij.

#### **Neni 12. Kushti i humbjes totale konstruktive**

Asnjë kërkesë për humbje totale konstruktive nuk do të jetë e dëmshpërblyeshme sipas këtij sigurimi, në se objekti i siguruar nuk braktiset arsyeshëm (malli dhe/ose anija), në konsideratë të humbjes totale aktuale të paevitueshme, dhe/ose sepse kosto e rifitimit, riparimit dhe dërgimit të objektit të siguruar (mallit, objekt sigurimi), për në destinacionin e siguruar do të kalojë vlerën e tij, në kohën kur do të mbërrijë në destinacion.

#### **Neni 13. Kushti i Vlerës Shtesë**

Nëse i Siguruari siguron me një shumë shtesë mallin e siguruar me këtë kontratë sigurimi kjo shumë e shtuar sigurimi do të konsiderohet si e shtuar shumë të siguruar të kësaj kontrate (fillestare). Në rast dëmsh mbulimi i humbjeve dhe përgjegjësi sipas kësaj kontrate sigurimi do të realizohet nga të gjithë Siguruesit e mallit në transport, në përputhje me raportin ndërmjet shumës së sigurimit të nënshkruar të çdo Siguruesi përkundërt totalit të këtyre shumave të sigurimit. Në rast dëmi i Siguarit duhet të paraqesë Siguruesve dëshmi të shumave të siguruar, sipas të gjitha sigurimeve të tjera.

#### **Neni 14. Kontrata e sigurimit (kerkesë-pyetsori, polica, shuma e sigurimit, prirje)**

##### **14.1. Përmbytja e kerkesë - pyetsorit:**

Kontrata e sigurimit lidhet mbasi pranohet nga Siguruesi, një kërkesë me shkrim, e plotësuar nga ana e të Siguarit, e cila duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a. emrin e të Siguarit (blerësit dhe/ose shitësit apo importuesit dhe/ose eksportuesit).

b. shoqërinë spedicionere apo cilindo ent tjetër, që ka marrë përsiper realizimin e tranzitit.

c. emrin e pritësit të ngarkesës së siguruar.

d. vendin e ngarkimit, rrugën që do të ndjekë tranziti dhe destinacionin e mallrave.

e. përshkrimin e saktë të mallit, llojin e paketimit, numrin e pakove, peshën bruto dhe neto të tij, numrin/at dhe datën/at e

policës/ave të ngarkeses, ose dokumentave të tjerë, që shoqërojnë transportin e ngarkesës së siguruar.

**f.** llojin e mjetit/ve të transportit që përfshihen në kryerjen e tranzitit.

- për transportin detar (emrin, vitin e ndërtimit, dhe flamurin e anijes).

- për transportin tokësor (tipin, marken, targat përfshi edhe ato të rimorkos).

- për transportin hekurudhor (linjën hekurudhore që do të përshkohet, emërtesen e mjetit hekurudhor dhe numrin e vagonave, që do të kryejë transportin).

**g.** shumën e sigurimit të mallit.

**h.** nivelin e mbulimit me sigurim të mallit, objekt sigurimi.

**14.2. Polica e sigurimit** është dëshmia e lidhjes së kontratës së sigurimit.

Përveç një përmbledhje të të dhënave si më sipër, në të shënohet, niveli i mbulimit, shuma e sigurimit, vlera e primit dhe adresa e Survejerit (mbikqyresit), të dëmit në rastin e vertetimit të ngjarjes së sigurimit.

**14.3. Franshiza dhe Pjesa e Zbritshme.**

Në policë shënohen detyrimisht elementët kufizues të dëmit franshiza dhe pjesa e zbritshme. Franshiza shprehet në vlerë nominale në monedhën e caktuar dhe përcakton një kufi në dhe nën të cilin dëmi nuk trajtohet. Pjesa e Zbritshme shprehet në përqindje mbi vlerën e dëmit dhe përcakton pjesën që mban në çdo rast dëmi të trajtueshëm, i Siguruari.

Franshiza dhe Pjesa e Zbritshme përlogariten për çdo një dëm ose seri dëmsh që rrjedhin nga një ngjarje e vetme sigurimi.

**14.4. Shuma e sigurimit,** i korespondon vlerës së mallrave në kohën dhe vendin e fillimit të udhëtimit të siguruar duke i shtuar shpenzimet e transportit, koston e sigurimit dhe shpenzime të tjera (si ato doganore etj), që shoqërojnë ngarkesën deri në destinacion.

Si rregull, shuma e siguruar përcaktohet dhe është e barabartë me vlerën e zëvendësimit të mallit/ave të siguruar dhe përbën kufirin maksimal të çdo dëmshpërblimi, me rastin e vertetimit të ngjarjes së sigurimit.

Vlera e mallit/ave për efekt të përlogaritjes së dëmshpërblimit, përcaktohet duke u bazuar në vlerën e tyre, në kohën e ndodhjes së humbjes ose dëmit në vendin e fillimit të tranzitit. Në mungesë të dëshmive vlera e zëvendësimit është pranuar ti korespondojë shumës së siguruar.

Në qoftë se shuma e siguruar e shënuar në policë është më e ulët se vlera e zëvendësimit të mallit, në çdo rast dëmi Siguruesi është përgjegjës vetëm për vlerën e dëmit, mbas aplikimit të koeficientit të nënsigurimit.

**14.5. Pagimi i primit dhe hyrja në fuqi e kontratës.**

Kontrata e sigurimit quhet e lidhur nga çasti i lëshimit të policës së sigurimit.

Kontrata e sigurimit nuk hyn në fuqi para pagimit të primit, në qoftë se nuk parashikohet ndryshe në kontratë.

I Siguruari detyrohet t'i paguaj Siguruesit primin e caktuar në monedhën përkatëse, që kushtëzohet dhe monedhën e dëmshpërblimit me vertetimin e ngjarjes së sigurimit.

Pagesa e primit për kontratat e hapura, mbas pagimit të kështit të parë të tij që bën të mundur hyrjen e kontratës në fuqi, kryhet periodikisht në përputhje me afatet e përcaktuara. Si rregull kështet vijues të primit, paguhen brenda datës, 20 të muajit pasardhës, për transportet e kryera në periudhën paraardhëse.

I Siguruari përpara kryerjes së çdo transporti është i detyruar të njoftojë Siguruesin për planifikimin e kryerjes së tij, në përputhje me të dhënat dhe formën e rënë dakort.

**Neni 15. Detyrimet e të Siguruarit**

**15.1.** I Siguruari është i detyruar t'i paraqesë Siguruesit, me njohjen më të mirë të tij, të gjitha rrethanat (faktet), që ndikojnë në vlerësimin e rrezikut.

I Siguruari, punonjësit dhe agjentët e tij, lidhur me humbje të dëmshpërbllyeshme, sipas këtij sigurimi duhet:

**15.2.** Të japë njoftim të menjëhershëm, përveç Siguruesit (degës lëshuese të policës), edhe në adresën e Survejerit të dëmit, dhe e drejta e mbulimit (dëmshpërblimit), varet nga zbatimi i këtij detyrimi. Menjëherë në kuptimin e këtij neni do të thotë që i

Siguruari duhet të njoftojë Siguruesin, brenda 48 oreve nga çasti që ka marrë dijëni për ngjarjen e sigurimit.

I Siguruari duhet për:

- dëmet e dukshme të njoftojë me shkrim transportuesit përpara marrjes në dorëzim të mallrave,

- dëme, që nuk janë të dukshme nga ana e jashtme, të njoftojë jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të magazinimit të mallrave të siguruar, në magazinën përfundimtare.

Për dëmet e ndodhura në territorin Shqiptar Survejor (Mbikqyrësi i dëmit) është gjithnjë ALBSIG SHA, për dëmet e ndodhura jashtë shtetit mund të jetë edhe një përfaqësues i tij. Në çdo rast emri i Survejerit dhe nr. i kontaktit shënohet në policën e sigurimit.

**15.3.** Të marrë masa të arësyeshme me qëllim të shmangjes ose zvoglimit të humbjeve ose dëmeve, dhe të sigurojë që të gjitha të drejtat kundrejt transportuesve, pritesve ose paleve të tjera të treta, të përfshira në këtë transport, të ruhen dhe ushtrohen në mënyrën e duhur, dhe Siguruesit në shtese të çdo humbje të dëmshpërbllyeshme sipas këtij sigurimi do të rimbursojë të Siguruarin për çdo shpenzim të arësyeshem dhe të përshtatshëm, të kryer në përputhje me këtë detyrim.

**15.4.** I Siguruari duhet të provoje që në tranzitin e siguruar, mallrat kanë pësuar humbje ose dëme, për të cilat Siguruesi është përgjegjës, sipas kësaj kontrate.

Gjithashtu ai do të paraqesë kërkesën e dëmshpërblimit Siguruesit, së bashku me të gjitha dokumentet e nevojshme, origjinale ose të noteruara si, *police e sigurimit, faturen/at e mallit, çertifikaten e origjinës së mallit, fletë ngarkesën, protestën detare të kapitenit të anijes, proces-verbalin e autoriteteve për ndodhjen dhe pasojat e ngjarjes së jashtëzakonshme, proces verbalit me transportuesin/it, raportin e ekspertit dhe/ose raportin e Survejerit kur është ndryshe nga Siguruesi, përlogaritjen e madhësisë së dëmit, proces verbalin e rivlerësimit të mallrave të dëmtuara që mund të perdoren, si dhe dokumente të tjera që mund të disponojë ose i kerkohen, për vlerësimin e ngjarjes së sigurimit dhe dëmit.*

**Neni 16. Pagesa e dëmshpërblimit dhe transferimi i të drejtës së rekursit.**

**16.1** I Siguruari duhet t'i lëshojë Siguruesit një deklaratë të shkruar dhe të hartuar në përputhje me ligjin për kalimin e të gjitha të drejtave përkundrejt palës përgjegjëse për shkaktimin e dëmit. Kjo e drejtë në favor të Siguruesit bëhet efektive sapo Siguruesi të ketë plotësuar detyrimin e tij, me rastin e vertetimit të ngjarjes së sigurimit, pagesën e dëmshpërblimit.

**16.2** Nëse i Siguruari nga pakujdesia e rendë nuk përmbush detyrimin e përcaktuar si më sipër, Siguruesi ka të drejtën e mbajtjes nga shuma e dëmshpërblimit që i takon të Siguruarit vlerën e parimbursueshme të shkaktuar nga kjo pakujdesia e rendë e tij.

**16.3** Kur i Siguruari merr nga persona të tretë një pjesë të dëmshpërblimit për dëmin e pësuar, Siguruesi paguan diferencën, deri në kufirin maksimal të përgjegjësisë së tij.

**Neni 17. Transferimi i kontratës**

I Siguruari, nëse ka rënë dakord me Siguruesin, ka të drejtë, që të gjitha të drejtat nga kontrata e sigurimit t'ua transferojë personave të tjerë, të cilët kanë ose mund të kenë interes material të justifikueshëm mbi mallin e siguruar.

**Neni 18. Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

**18.1.** I siguruari ka të drejtë të kërkojë nga Siguruesi pagesën e dëmshpërblimit, brenda 24 muajve nga data e lindjes së kesaj të drejte.

**18.2.** Në qoftë se palet nuk bien dakort sa i përket shkakut, natyrës dhe masës së humbjes ose dëmit, do të thirret me pëlqimin e përbashkët të paleve një ekspert ose specialist i fushës. Raporti i ekspertit do të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme për të përcaktuar shkakun, përgjegjësinë e Siguruesit dhe për të vlerësuar shumën e humbjes ose dëmit.

**18.3.** Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin nga kontrata e sigurimit ndërmjet Siguruesit dhe të siguruarve, zgjidhen nga gjykata kompetente e vendit ku lëshohet polica e sigurimit.